



**Universiteti i Elbasanit
"Aleksandër Xhuvani"**



STRATEGJIA E ZHVILLIMIT INSTITUCIONAL 2020-2024

Elbasan, shtator 2020





Qëllimi i Strategjisë së Zhvillimit 2020-2024

Qëllimi i këtij dokumenti strategjik është të parashtrojë vizionin e zhvillimit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", në vijim UE, në katër vitet në vazhdim, duke marrë parasysh sfidat e rëndësishme që do të shoqërojnë zbatimin e saj. Ky dokument është i ndarë në katër pjesë kryesore.

-Pjesa e parë është pjesa prezantuese e institucionit, një pasqyrim i zhvillimit dhe rritjes së tij në vite.

-Pjesa e dytë përcakton elementët më të rëndësishëm të vizionit, misionit dhe qëllimit të UE-së.

-Pjesa e tretë është pjesa përshkruese dhe analizuese e objektivave dhe përm-bushjes së tyre.

-Pjesa e katërt është pjesa e planit të veprimit dhe zbatimit të politikave të zh-villimit të tij në 4 vitet e ardhshme.

Secili vit akademik për Universitetin e Elbasanit është një vit vendimtar për-sa i përket krijimit të kuadrit rregullativ dhe institucional për mirëqeverisjen e tij, por edhe si detyrim i ligjit të arsimit të lartë. Në të njëjtën kohë ky ligj ka nën-vizuar nevojën për t'u dhënë përgjigje sfidave të menjëhershme me të cilat UE ballafaqohet. Këto sfida lidhen kryesisht me financimin e kërkimit shkencor dhe infrastrukturën, uljen e numrit të studentëve që ndjekin studimet në programet e mësuesisë, forcimit të kapaciteteve infrastrukturore, ofrimin e programeve të studimit në gjuhë të huaj etj.

Universiteti i Elbasanit synon që përpos akreditimit të suksesshëm institucional të realizojë akreditimin e programeve të studimit në të gjitha ciklet. Gjithash-tu, ofrimi i programeve të studimit doktorale në njësitë përbërëse të UE-së mbetet një prioritet i padiskutueshëm.

Nën moton "Nga tradita, drejt suksesit", UE me të gjitha strukturat përbërëse të tij angazhohet për zbatimin në kohë dhe me përpikëri të këtij dokumenti.

REKTORI

Prof.dr.Skender TOPI



Tabela e përmbajtjes

Qëllimi i Strategjisë së Zhvillimit 2020-2024.....	2
Prezantimi i UE.....	4
Vizioni.....	6
Misioni.....	6
Qëllimi.....	7
Objektivat e strategjisë.....	7
-Studentët.....	7
-Kurrikula.....	8
-Burime njerëzore.....	9
-Ndërkombëtarizimi.....	10
-Financimi.....	11
-Bashkëpunimi	11
-Infrastruktura dhe teknologjia.....	12
Plani i veprimit për përmbushjen e objektivave.....	13
-Për studentët.....	13
-Për kurrikulën.....	13
-Për burimet njerëzore.....	14
-Për ndërkombëtarizimin.....	14
-Për financimin.....	15
-Për bashkëpunimin.....	15
-Për infrastrukturën dhe teknologjinë.....	15

1. PREZANTIMI I UNIVERSITETIT TË ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", i themeluar në vitin 1991, është institucion i rëndësishëm arsimor e shkencor në Republikën e Shqipërisë, një nga universitetet më në zë të vendit për përgatitjen e mësuesve, të specialistëve dhe studiuesve të rinj në fusha të ndryshme të studimeve. Historia e tij prej afro 4 dekadash ka njohur arritje të dukshme në shumë fusha të arsimit dhe kërkimit shkencor.

Universiteti është ngritur mbi një traditë të pasur në këtë drejtim. Pa dyshim, kjo traditë është e lidhur ngushtë me Shkollën Normale, të çelur më 1909, e cila luajti për shumë kohë rolin e një universiteti të vërtetë. Nga ajo dolën breza të tërë mësuesish për gjithë trevat shqiptare, të cilët për vite me radhë u përgatitën sipas njohurive më bashkëkohore për kohën (1909-1950), të ngjashme me ato të shumë vendeve të zhvilluara të Evropës, si Zvicër, Francë, Austri etj. Shkolla Normale përvijoi qartë vendin e rëndësishëm të saj në arsimin kombëtar e për më tepër edhe rolin e saj në historinë tonë kombëtare. Vlerat e krijuara në Shkollën Normale pasqyrohen qartë në historinë e arsimit tonë kombëtar e më gjerë. Në historinë e kombit tonë, Elbasani ka luajtur një rol të rëndësishëm në lëmin e arsimit, dijes dhe shkencës."

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" është institucion i ngritur në statusin universitar mbi Institutin e Lartë Pedagogjik "Aleksandër Xhuvani" (ILP). ILP-ja, ky institucion i lartë arsimor, që ka përgatitur mësues për shkollën 8-vjeçare dhe të mesme, u ngrit në vitin 1971 dhe ka funksionuar deri më 1991. ILP u themelua duke u mbështetur në traditën e përgatitjes së mësuesve në shkollën Normale të Elbasanit, si dhe në përvojën e grumbulluar në dy filialet pararendëse të tij, një i Universitetit të Tiranës dhe tjetri i Institutit të Lartë Pedagogjik të Shkodrës, si dhe të trashëgimisë së veprimtarisë së gjerë shkencore e arsimore të mjaft studiuesve e mësuesve elbasanas.

Fillimisht ILP-ja ka kryer veprimtarinë e vet mësimore në katër degë të mësuesisë: gjuhë-letërsi, matematikë-fizikë, histori-gjeografi, biologji-kimi, në sistemin me dhe pa shkëputje nga puna, me kohëzgjatje trevjeçare; në degët inxhinieri ndërtimi, inxhinieri mekanike, ekonomi kontabël, ekonomi plan, si filialet të UT-së. Ky institucion zhvilloi veprimtari në filialet e tij të ngritura në qytetet Korçë, Fier dhe Berat. Në vitin 1981 u hap dega e përgatitjes së mësuesve për katër klasat e para të shkollës 8-vjeçare, me kohëzgjatje studimi 3 vjet. Afati i studimeve në ILP më 1982 u shtri nga tre në katër vjet. Pranë tij kanë funksionuar pesë katedra:

1. Katedra e gjuhës shqipe dhe letërsisë
2. Katedra e histori-gjeografisë
3. Katedra e matematikë-fizikës
4. Katedra e biologji-kimisë
5. Katedra e lëndëve psiko-didaktike dhe e djathtësive.



Në vitin 1991, ILP "Aleksandër Xhuvani" fiton statusin e institucionit universitar, duke u emërtuar Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.414, dt.12.11.1991, duke ruajtur me krenari origjinën e Institutit të Lartë Pedagogjik "Aleksandër Xhuvani" (ILP) themeluar më 1971, i cili u përvijua si vazhdues i drejtpërdrejtë i Shkollës Normale të Elbasanit (i pari institucion kombëtar i përgatitjes së mësuesve në Shqipëri, themeluar më 1909). Veprimtaria e Universitetit bazohet në nenin 57, pika 7, të Kushtetutës, në ligjin nr.80/2015 datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në Statutin e UE-së si dhe në rregulloret që miratohen në zbatim të tij.

Aktualisht UE, përbëhet nga 5 fakultete, ku studiohet me kohë të plotë në programet e studimit Bachelor, Master profesional, Master i shkencave, Diplomë profesionale 2-vjeçare si dhe Doktoratë.

Në mënyrë të detajuar në UE funksionojnë:

I. Fakulteti i Shkencave Humane, me programe studimi Bachelor, Master profesional, Master i shkencave në fushat e kërkimit: gjuhë shqipe, gjuhë e huaj (anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht), histori, gjeografi, gazetari, albanologji.

II. Fakulteti i Shkencave të Natyrës, me programe studimi Bachelor, Master profesional dhe Master i shkencave në fushat e kërkimit: biologji, kimi, botanikë, zoologji, mbrojtje mjedisi, matematikë, fizikë, teknologji e informacionit, informatikë, gjeometri, fizikë teorike e eksperimentale.

III. Fakulteti i Shkencave të Edukimit, me programe studimi Bachelor, Master profesional në fushat e kërkimit: mësuesi për ciklin fillor (klasës I-IV të shkollës 9-vjeçare), edukatorë për arsimin parashkollor, psikologji, filozofi, sociologji, edukim artistik, fizik dhe sporte.

IV. Fakulteti Ekonomik, me programe studimi Bachelor, Master profesional dhe Master i shkencave në fushat e kërkimit: administrim, biznes, financë, kontabilitet, ekonomia dhe e drejta, drejtësi, ekonomi-turizëm, administrim-biznes dhe inxhinieri dhe informatikë ekonomike.

V. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, programe studimi Bachelor, Master profesional dhe Master i shkencave në fushat e kërkimit: infermieri, infermieri mami, teknik laborator, imazheri, fizioterapi dhe logopedi.

Në UE ofrohen gjithashtu 7 (shtatë) programe studime me karakter profesional. Kohëzgjatja e tyre normale është një ose dy vite akademike dhe në përfundim lëshohet respektivisht "Certifikatë profesionale" ose "Diplomë profesionale" në fushën e arsimimit përkatës.

Që nga themelimi i UE-së (1991) e në vijimësi punohet për krijimin e strukturave dhe institucioneve ndihmëse për procesin mësimor dhe veprimtarinë kërkimore-shkencore.

VIZIONI I UNIVERSITETIT TË ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”

UE është dhe synon të mbetet një nga institucionet më të rëndësishme të arsimit të lartë publik në Shqipëri. Vizioni për rritjen dhe zhvillimin e UE konsiston në realizimin e modernizimit dhe reformimit të institucionit, duke e kthyer atë në një institucion të arsimit të lartë, nga tradita drejt suksesit.

MISIONI I UNIVERSITETIT TË ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”

UE si institucion i arsimit të lartë ka për mision:

- a) të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor, si dhe të nxisë e të zhvillojë artet, edukimin fizik dhe sportet;
- b) të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend;
- c) të ofrojë mundësi të barabarta për të përfituar nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatëgjithë jetës;
- d) të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal, si dhe në forcimin e sigurisë publike dhe kombëtare;
- e) të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit;
- f) të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor;
- g) të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë.



QËLLIMI

Si institucion i kulturës dhe traditës, UE ka si qëllim të ruajë me fanatizëm programet e studimit themelues të tij e nga ana tjetër të pasurojë kurrikulën universitare me programe të reja studimi. Këto programe do të shoqërohen me krijimin e infrastrukturës së përshtatshme, burimeve njerëzore si dhe me politika mbështetëse për studentët e personelin e UE-së.



OBJEKTIVAT

Objektivi kryesor i UE-së është të formojë profesionistë të aftë për të përballur sfidat e zhvillimit në fushat e shkencave humane, natyrore, ekonomike, të edukimit si dhe shkencave mjekësore e teknike.

1.1 STUDENTËT

Studentët janë në qendër të zhvillimit dhe punës në UE. Institucioni synon të përmirësojë rolin dhe hapësirat studentore duke:

- plotësuar jetën studentore jo vetëm me aftësimin e tyre akademik e profesional, por edhe në zhvillimin e aftësive ndërpersonale dhe talenteve të mbartura, kulturore dhe sportive;
- krijuar hapësira ku studentët të mund të shpalosin dhe të zhvillojnë talentet e tyre, për të rritur motivimin dhe performancën e tyre akademike, si dhe ndërveprimin me njëri-tjetrin;
- përfaqësuar zërin e studentëve në organet vendimmarrëse dhe në struktura të rëndësishme për politikën e UE-së;
- përfshirë studentët në procese të rëndësishme për mbarëvajtjen institucionale;
- realizuar shkëmbimin e tyre në institucione partnere;
- nxitur dhe zhvilluar metoda të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimxënies;
- nxitur kërkimin shkencor dhe inovacionin;
- kryer trajnime dhe kualifikime të vazhduara dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës;
- patur qasje të pakushtëzuar në bibliotekën fizike dhe elektronike.



1.2 KURRIKULA

UE synon përmirësimin dhe përditësimin e kurrikulave akademike, duke marrë parasysh studimin e tregut, zhvillimin e teknologjisë dhe përditësimin e literaturës nëpërmjet:

- hapjes së programeve të reja të studimit për të plotësuar vazhdimësinë e studimeve nga bachelor në master;
- hapjes së programeve të reja të studimit me karakter profesional;
 - organizimit të programeve të ciklit të tretë të studimit;
 - përditësimit të programeve të studimit për t'iu përgjigjur dinamizmit të tregut të punës;
- përditësimit të literaturës së detyrueshme dhe fakultative për secilin program studimi;
- zgjerimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit për realizimin e praktikave mësimore dhe praktikave në terren.

1.3 BURIMET NJERËZORE


UE synon garantimin e burimeve njerëzore për personelin akademik, ndihmësakademik e administrativ në institucion. Garantimi i burimeve njerëzore nënkupton:

- rritjen e numrit të personelit akademik të UE-së në mënyrë që t'i përgjigjet sa më mirë procesit mësimor dhe raportit student-pedagog;
- rritjen e numrit të personelit ndihmësakademik dhe administrativ të UE-së, për të rritur cilësinë në ofrimin e shërbimeve;
- forcimin e kapaciteteve të strukturave për koordinim mes njësive dhe shpërndarjes së informacionit;
- forcimin e kapaciteteve të strukturave për mbështetjen, orientimin dhe këshillimin e studentëve;
- forcimin e kapaciteteve të strukturave për garantimin e cilësisë në institucion;
- krijimin e mundësive për rekrutimin e talenteve të reja dhe profesionistëve më të mirë;
- krijimin e hapësirave për rekrutimin e ish-studentëve të UE-së;
- zbatim të strategjive efektive të rinovimit të personelit, përmes ofrimit të kontratave një vjeçare për asistentë-lektorë, duke nxitur tërheqjen e stafit të ri akademik;
- realizimit të promovimit të personelit akademik;
- rritjen e numrit të mobiliteteve jashtë vendit;
- krijimit të mundësive për personelin akademik për mësimdhënie jashtë vendit si profesorë të ftuar;
- mbështetjes financiare për personelin dhe angazhimin e tyre për orët mbi normë osenë komisione institucionale.

1.4 NDËRKOMBËTARIZIMI

Prioritet dhe njëkohësisht sfidë për Universitetin e Elbasanit mbetet fuqizimi dhe diversifikimi i ndërkombëtarizimit të tij. UE do të bëjë të gjitha përpjekjet për të ndërkombëtarizuar dhe për të shtrirë më tej bashkëpunimin në nivel ndërkombëtar me universitete dhe institucione të arsimit të lartë. Në këtë mënyrë do të vazhdojë bashkëpunimin marrëveshjeve ekzistuese për bashkëpunim ndërkombëtar, si dhe do të promovohet lidhja e marrëveshjeve të reja, duke qenë të vetëdijshëm se çdo projekt i përbashkët kërkimor është në funksion të përparimit të veprimtarisë kërkimore shkencore në institucion. Kjo do të arrihet nëpërmjet:

- rritjes së numrit të bashkëpunimeve për realizimin e mobiliteteve;
- aderimit në shoqata dhe organizata ndërkombëtare;
- pjesëmarrjes në projekte për ngritjen e kapaciteteve;
- zgjerimit të ofertës akademike për studentët ndërkombëtarë në UE;
- ofrimit të moduleve dhe lëndëve në gjuhën angleze;
- organizmit të aktiviteteve ndërkombëtare kërkimore shkencore;
- krijimit të produkteve kërkimore shkencore ndërkombëtare;
- afrimit të profesorëve të ftuar nga jashtë Shqipërisë;
- pjesëmarrjes me aplikime për programet e shkëmbimit të personelit akademik, të ofruara nga ambasadat e vendeve të ndryshme në Shqipëri.



1.5 FINANCIMI

Për realizimin e objektivave, financimi luan rolin më të rëndësishëm. Financimi i UE-së realizohet nëpërmjet dy burimeve: nga grantet e buxhetit të shtetit dhe të ardhurat dytësore (që realizohen nga vetë institucioni dhe nga financime të tjera). UE ka si qëllim të fuqizojë financat e tij nëpërmjet:

- përmirësimit të efektivitetit dhe efikasitetit të financave të tij;
- rritjes të ardhurave nëpërmjet nxitjes dhe përfshirjes në projekte kërkimore shkencore, kombëtare dhe ndërkombëtare;
- financimit të programeve të reja të studimit;
- investimeve në infrastrukturë;
- financimit të projekteve kërkimore shkencore;
- investimit në pasurimin e fondit të librit;
- ofrimin të këshillimit dhe shërbimeve për të tretët;
- financimit të aktiviteteve, praktikave në terren për studentët;
- përmirësimit të menaxhimit të shpenzimeve, duke rritur transparencën dhe efikasitetin e tyre.



1.6 BASHKËPUNIMI

Promovimi i bashkëpunimit do të realizohet në dy aspekte:

- bashkëpunim i brendshëm i organeve kolegjiale, autoriteteve drejtuese dhe strukturave të tjera, në nivel institucioni, njësie kryesore dhe njësie bazë. Pjesë e bashkëpunimit është nxitja dhe zhvillimi i dialogut konstruktiv dhe transparenca në vendimmarrje.
- bashkëpunimi i jashtëm do të konsistojë në bashkëpunimin me institucione të arsimit të lartë, institucione të qeverisjes vendore e qendrore për realizimin e misionit dhe përmbushjen e qëllimeve të UE-së.



1.7 INFRASTRUKTURA DHE TEKNOLOGJIA

Përmirësimi i infrastrukturës dhe teknologjisë sipas modeleve të zhvillimit në vend e në botë do të pasqyrohet edhe në UE nëpërmjet ofrimit të platformave të mësimdhënies on-line, qasjes në librari elektronike dhe platformave për të mësuarin gjatë gjithë jetës. Këto mundësojnë rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve ndaj studentëve, stafit akademik dhe palëve të treta.

Universiteti ynë do të synojë përmirësimin e ambienteve aktuale (sallat e mësimi, laboratorët, kabinetet e informatikës, internetit, bibliotekat etj.) duke i pajisur ato me mjetet e nevojshme didaktike, audiovizive e multimediale moderne.

2. PLANI I VEPRIMIT PËR PËRMBUSHJEN E OBJEKTIVAVE

Për realizimin e objektivave të mësipërme është përpiluar edhe një plan veprimi që synon planifikimin dhe monitorimin e hapave të domosdoshme për të mundësuar zbatimin e objektivave të parashtruara. Gjithashtu, struktura e UE-së do të rikoncepohet në mënyrë që t'i përgjigjet më mirë realizimit të misionit dhe objektivave të UE-së dhe kësaj strategjie.

2.1 PLAN VEPRIMI PËR STUDENTËT

- do të shtohen kuotat për pranimin e studentëve në përputhje me standardet akademike dhe infrastrukture.
- do të sigurohet respektimi i meritokracisë dhe vlerësimit të performancës për përzgjedhjen e studentëve në ciklin e studimeve Bachelor dhe Master.
- do të sigurohet respektimi i meritokracisë dhe vlerësimit të performancës për përzgjedhjen e studentëve në programet e studimit me karakter profesional;
- do të mundësohen programe studimi të doktoratës në fusha të ndryshme të kërkimit shkencor, referuar projekteve kërkimore shkencore specifike;
- do të përmirësohen shërbimet e ofruara ndaj studentëve, duke rritur transparencën dhe nivelin e marrjes së informacionit;
- do të organizohen aktivitete trajnuese dhe formuese për të gjithë studentët e UE.

2.2 PLAN VEPRIMI PËR KURRIKULËN

- do të hapen programe të reja të studimit master profesional dhe master i shkencave për të plotësuar studimet e vazhduara bachelor;
- do të hapen programe të reja të studimit me karakter profesional 2-vjeçar;
- do të riorganizohen programet e studimit të mësuesisë;
- do të realizohen programet e studimit të doktoratës në fusha të ndryshme të kërkimit shkencor, referuar projekteve kërkimore shkencore specifike;
- do të hartohen programe të përbashkëta studimi me universitet partnere brenda dhe jashtë Shqipërisë;
- do të realizohet akreditimi i programeve të studimit të ofruara në UE;
- do të zgjerohen marrëveshjet e bashkëpunimit për realizimin e praktikave mësimore dhe praktikave në terren.

2.3 PLAN VEPRIMI PËR BURIMET NJERËZORE

- do të rritet numri i personelit akademik në përputhje me normativat që kërkon Ligji i Arsimit të Lartë dhe udhëzimet e tij përkatëse;
- do të forcohen kapacitetet e personelit ndihmës akademik dhe administrativ të UE-së, për t'iu përshtatur strukturave të reja që duhet të krijohen me ligjin e arsimit të lartë;
- do të bëhet një shpërndarje e drejtë dhe e ekuilibruar e ngarkesës mësimore në lëndët e një programi studimi;
- do të përdoret me efikasitet autonomia financiare ligjore për të krijuar hapësirat dhe lehtësirat e nevojshme në mbështetje të aktivitetit akademik;
- do të forcohen kapacitetet për koordinim mes njësive dhe shpërndarjes së informacionit;
- do të rriten në total të ardhurat e pedagogëve deri në masën 30%, duke garantuar rritje dhe kryerje në kohë të pagesave të aktivitetit mësimor, mbingarkesat dhe orët jashtë orarit.

2.4 PLAN VEPRIMI PËR NDËRKOMBËTARIZIMIN

- do të rritet numri i bashkëpunimeve për realizimin e mobiliteteve;
- do të aderojmë në rrjete dhe organizata ndërkombëtare në fushën e arsimit të lartë, kërkimit shkencor dhe inovacionit;
- do të rrisë numrin e pjesëmarrjes në projekte për ngritjen e kapaciteteve;
- do të hartojë dhe zbatojë një ofertë akademike për studentët ndërkombëtarë;
- do të ofrojë module e lëndë në gjuhën angleze;
- do të organizojë dhe bashkëorganizojë aktivitete ndërkombëtare të kërkimit shkencor;
- do të ofrojë publikimin e artikujve në gjuhë të huaj në Buletinin Shkencor UNIEL;
- do të bashkëpunojë me personel akademik të huaj për shkëmbim përvojash dhe ekspertizë në fusha specifike ose me interes për institucionin;
- do të krijojë produkte kërkimore shkencore ndërkombëtare;
- do të bëjë pjesë të profesorëve të ftuar personalitete të nderuara ndërkombëtare;
- do të përfshihen në programin e mobiliteteve Erasmus+ të gjitha programet e studimit të UE-së.



2.5 PLAN VEPRIMI PËR FINANCIMIN

- do të rrisë të ardhurat e tij nëpërmjet përfshirjes në projekte kërkimore shkencore, kombëtare dhe ndërkombëtare;
- do të financojë hapjen dhe organizimin e programeve të reja të studimit;
- do të financohen projektet kërkimore shkencore si dhe pasurimi i fondit të librit;
- do të financohen aktivitete, praktika në terren për studentët;
- do të rritet transparenca për menaxhimin e shpenzimeve.

2.6 PLAN VEPRIMI PËR BASHKËPUNIMIN

- do të rritet bashkëpunim i brendshëm i organeve kolegjiale, autoriteteve drejtuese dhe strukturave të tjera në nivel institucioni, njësie kryesore dhe njësie bazë, nëpërmjet rritjes së nivelit të përfaqësimit dhe transparencës në vendimmarrje.
- do të rritet bashkëpunimi jashtë UE-së duke nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me interes të përbashkët me të gjitha institucionet e arsimit të lartë publik në Shqipëri, me Kuvendin, bashkitë, drejtoritë rajonale, ministritë etj.

2.7 PLAN VEPRIMI PËR INFRASTRUKTURËNDHE TEKNOLOGJINË

- forcimi i kapaciteteve për ofrimin e programeve të studimit në distancë në UE;
- shtimi i numrit të laboratorëve të teknologjisë së informacionit në të gjitha njësitë e UE-së;
- ridimensionohen hapësirat publike të përbashkëta;
- përditësimi i faqes web të UE-së;
- krijimi i aplikacionit për sistemin EMS për studentët.

The foundations of the University of Elbasan "Aleksandër Xhuvani" (UE) date back to 1909 where the NORMALE school was established, the first in Albania, which prepared teachers for all the republic. This school was later transformed into the High Pedagogical Institute where in 1991 it received the status of the University. The first faculty created, was the Faculty of Education, to promote and to move on the tradition, regarding the preparation and graduation of teachers.



Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"

Rruga "Ismail Zyma", Elbasan,
Tel. +355 54 252593, www.uniel.edu.al,
info@uniel.edu.al